



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	11.09.2024
REFERENC-Ë:	23/6074/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"BADALLAJ 5", Sh.p.k., Vllashnje, Prizren Riciklim e mbeturinave inerte, Zhur, Prizren.
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKU/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për ndërprerje të procedurës administrative

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për vazhdim të Lejes Mjedisore, operatorit, "BADALLAJ 5", Sh.p.k., Vllashnje, Prizren, Nr.Prot.23/6074/MMPHI, për veprimtarinë: Riciklim e mbeturinave inerte, Zhur, Prizren.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 23/6074/MMPHI
Datë: 11.09.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe neni 9 paragrafi 1.4 i Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatori, "BADALLAJ 5", Sh.p.k., Vllashnje, Prizren, i **ndërpritet** procedura administrative për pajisje me Leje, për veprimtarinë: Riciklim e mbeturinave inerte, Zhur, Prizren, në ngastrën, nr. 05007-2, zona kadastrale Zhur, Prizren.

A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin, "BADALLAJ 5", Sh.p.k., Vllashnje, Prizren, i ndërpritet procedura administrative për pajisje me Leje Mjedisore për veprimtarinë: Riciklim e mbeturinave inerte, Zhur, Prizren, në ngastrën, nr. 05007-2 zona kadastrale, Zhur, Prizren.

Komisioni për shqyrtimin e kërkesës për leje Mjedisore ka kontrolluar dokumentacionin dhe në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022, ka gjetur që operatori sipas Pëlqimit Mjedisor me nr.22/4300/1-ZSP/178/22, të lëshuar me datë:03.10.2022, nuk ka filluar veprimtarinë në pajtim me Nenin 25, të Ligjit për VNM, NR. 03/L-214.

Komisioni për Leje Mjedisore në takimin e mbajtur të datës: dt. 11.09.2024, ka konstatuar edhe sipas gjendjes në teren që operatori, "BADALLAJ 5", Sh.p.k., Vllashnje, nuk ka të instaluar pajisjet për këtë veprimtari dhe nuk e ka të caktuar ngastrën për përgatitje për operim të veprimtarisë: Riciklim e mbeturinave inerte, siç ka pretenduar në aplikacion.

Operatori, "BADALLAJ 5", Sh.p.k., Vllashnje, Prizren, nuk i plotëson kriteret e parapara, për pajisje me Leje Mjedisore, pasi që nuk e ka kompletuar kërkesën me gjendjen faktike në teren, në pajtim me Nenin 25, të Ligjit për VNM, NR. 03/L-214, andaj i ndërpritet procedura administrative për pajisje me Leje.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, mbyll procedurën administrative në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Prizren;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.